

# REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE IKRTK PRILL 2024 – QERSHOR 2024

Nr. Rendor <sup>1</sup>	Data e kërkesës <sup>2</sup>	Objekti i kërkesës <sup>3</sup>	Data e përgjigjes <sup>4</sup>	Përgjigje <sup>5</sup>	Mënyra e përfundimit të kërkesës <sup>6</sup>	Tarifa <sup>7</sup>
2	09.04.2024	Kërkesë JGA “C.....” sh.p.k	09.04.2024	Delegim kompetence IKTK	E deleguar	S’ka
3	09.04.2024	Kërkesë “ S.....PV” Sh.p.k	09.04.2024	Delegim kompetence IKTK	E deleguar	S’ka
4	11.04.2024	Mbi ankimin ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopjeve të dokumentave zyrtare, Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale  Znj. E. A	15.04.2024	Në përgjigje të shkresës zyrtare nr. 974/1 prot., datë 11.04.2024 nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Mbi ankimin ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopjeve të dokumenteve zyrtare” administruar nga Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore (IKRTK), pas verifikimeve të kryera në adresën elektronike info@ikrtk.gov.al si dhe në arkiv protokollin e IKRTK, Ju informojmë se nuk administrojmë asnjë kërkesë për informacion nga Znj. E. A. Për të shmangur çdo lloj paqartësie sugjerojmë që në vijim çdo kërkesë për informacion të përcillet edhe me shkresë zyrtare pranë IKRTK-së në adresën: Rr. “Aleksandër Moisiu”, Nr.76, ish Kinostudio “Shqipëria e Re”, Tiranë.  Lidhur me informacionin e kërkuar mbi pyetjet e parashtuara, në zbatim të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit” dhe Nenit 32 të Ligjit 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, pas shqyrtimit, verifikimeve të kryera në Bazën e të Dhënave Shtetërore “Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore (RKPK)”, Ju informojmë si vijon:  Pyetje 1: Sa pasuri kulturore materiale dhe jomateriale ka	E plotë	S’ka

			<p>regjistruar IKRTK në 10 vitet e fundit (specifikojini sipas viteve dhe tipologjisë, pronësisë)?</p> <p>Sqarime IKRTK: Në 10 vitet e fundit janë regjistruar .... pasuri kulturore të tipologjive: arte pamore, etnografi, arkeologji, arkitekturë dhe trashëgimi kulturore jomaterale në pronësi shtetërore/private/institucione fetare. Konkretisht në vitin 2014 janë regjistruar në total ....., në vitin 2015 janë regjistruar në total ....., në vitin 2016 janë regjistruar në total ....., në vitin 2017 janë regjistruar në total ....., në vitin 2018 janë regjistruar në total ....., në vitin 2019 janë regjistruar në total ....., në vitin 2020 janë regjistruar në total ....., në vitin 2021 janë regjistruar në total ....., në vitin 2022 janë regjistruar në total .... dhe janë përditësuar ..... objekte, në vitin 2023 janë regjistruar në total ..... dhe janë përditësuar ..... objekte, në vitin 2024 deri në 15.04.2024 janë regjistruar .....</p> <p>Pyetje 2: Sa përlogaritjet totali që ekziston, në raport me pasuritë e regjistruara?</p> <p>Sqarime IKRTK: Nuk ka statistika zyrtare se sa mundet të jetë totali i pasurive kulturore që ekzistojnë. Regjistrimi i pasurive kulturore është një punë që vijon që nga viti 1995.</p> <p>Pyetje 3: Sa pasuri të peizazhit ka regjistruar IKRTK në 10 vitet e fundit (specifikojini sipas viteve dhe tipologjisë)?</p> <p>Sqarime IKRTK: Nuk kemi asnjë procedurë regjistrimi për pasuri të peizazhit në 10 vitet e fundit.</p> <p>Pyetje 4: A ka përfunduar procesi i regjistrimit të pasurive kulturore nga ana e IKRTK-së?</p> <p>Sqarime IKRTK: Jo, sqaruar në pyetjen e dytë.</p> <p>Pyetje 5: Sa është numri i të gjitha pasurive kulturore të luajtshme dhe të paluajtshme në</p>	
--	--	--	---	--

				<p>vendin tonë?</p> <p>Sqarime IKRTK: Sikurse sqaruar edhe në pyetjen e dytë, nuk mundet të llogarisim sesa është totali i pasurive kulturore në vendin tonë. Për sa i përket pasurive kulturore të regjistruara në RKPK numri total për pasuritë kulturore të luajtshme dhe të paluajtshme është .....</p> <p>Pyetje 6: Sa është numri i pasurive kulturore që ruhen (specifikojini) nga rrjeti muzeor i vendit, nga galeritë e artit, nga personat privatë, nga institucionet e specializuara vendore e kombëtare dhe nga bashkësitë fetare të regjistruara me ligj?</p> <p>Sqarime IKRTK: Përgjigjur në pyetjen e pestë.</p> <p>Pyetje 7: Na vendosni në dispozicion një kopje të publikimit me titull, "Katalogu i objekteve kulturore të zhdukura 1990-2016", publikuar nga IKRTK (Ish-Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore) në vitin 2018;</p> <p>Sqarime IKRTK: Kopjen e publikimit "Katalogu i objekteve kulturore të zhdukura 1990-2016" do ta gjeni bashkëlidhur shkresës.</p> <p>Pyetje 8: Çfarë përmban Katalogu Kombëtar i Pasurive Kulturore në sistemin informatik?</p> <p>Sqarime IKRTK: Jemi në pritje të akteve nënligjore për vënien në funksion të Katalogut Kombëtar të Pasurive Kulturore.</p> <p>Pyetje 9: A është ai i aksesueshëm në internet?</p> <p>Sqarime IKRTK: Sqaruar në pyetjen e tetë.</p> <p>Pyetje 10: Çfarë përmban katalogu i fondit muzeor kombëtar?</p> <p>Sqarime IKRTK: Jemi në pritje të akteve nënligjore për vënien në funksion të Katalogut të Fondit Muzeor Kombëtar.</p>	
--	--	--	--	---	--

				<p>Pyetje 11: Çfarë përmban baza shtetërore e të dhënave të pasurive kulturore të vendin tonë?</p> <p>Sqarime IKRTK: Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore që nga viti 1995 deri më sot, përmban pasuritë kulturore që ruhen nga rrjeti muzeor i vendit, nga galeritë e artit, nga personat privatë, nga institucionet e specializuara vendore e kombëtare dhe nga bashkësitë fetare.</p> <p>Pyetje 12: Sa pasuri kulturore të vjedhura ekistojnë në bazën e të dhënave që disponon IKRTK?</p> <p>Sqarime IKRTK: Deri më sot rezultojnë ..... objekte të deklarura të humbura/vjedhura në RKP.</p> <p>Pyetje 13: Sa certifikata regjistrimi të pasurive kulturore, të luajtshme e të paluajtshme, janë lëshuar nga institucioni në 10 vitet e fundit (specifikojini sipas viteve);</p> <p>Sqarime IKRTK: Jemi në pritje të akteve nënligjore lidhur me këtë procedurë që ju kërkoni informacion.</p> <p>Pyetje 14: Sa është numri i ekspertëve vlerësues të pasurive kulturore që ka autoriteti juaj?</p> <p>Sqarime IKRTK: Jemi në pritje të akteve nënligjore lidhur me këtë procedurë që ju kërkoni informacion.</p> <p>Pyetje 15: Sa është numri i licencave të eksportit, në pajtim me parashikimet e ligjit që janë akorduar nga institucioni juaj në 10 vitet e fundit (specifikojini sipas viteve)?</p> <p>Sqarime IKRTK: Jemi në pritje të akteve nënligjore lidhur me këtë procedurë që ju kërkoni informacion.</p> <p>Pyetje 16: A disponon institucioni juaj një regjistër kombëtar të</p>	
--	--	--	--	--	--

			<p>licencave të eksportit të pasurive kulturore?</p> <p>Sqarime IKRTK: Jemi në pritje të akteve nënligjore lidhur me këtë procedurë që ju kërkoni informacion.</p> <p>Pyetje 17: Si realizohet mbikëqyrja dhe monitorimi i respektimit të drejtave të pronësisë e të lëvizjes së pasurive kulturore kombëtare?</p> <p>Sqarime IKRTK: Mbikëqyrja dhe monitorimi i respektimit të drejtave të pronësisë e të lëvizjes së pasurive kulturore kombëtare realizohen ndërmjet fushës Leje/Transaksion në RKKP ku regjistrohen lejet apo Urdhrat e Ministrisë.</p> <p>Pyetje 18: A keni ofruar ekspertizë apo a keni denoncuar raste specifike për pasuritë kulturore?</p> <p>Sqarime IKRTK: Po kemi ofruar, por janë raste që përmbajnë informacion të klasifikuar në bashkëpunim me Prokurorinë dhe Policinë e Shtetit.</p> <p>Pyetje 19: A keni gjetur shkelje të procedurave (regjimit) të qarkullimit kombëtar dhe ndërkombëtar të pasurive kulturore të luajtshme të certifikuara?</p> <p>Sqarime IKRTK: Termi “pasurive kulturore të luajtshme të certifikuara” i paqartë. Nëse bëhet fjalë për regjimin e eksport/import të pasurive kulturore sikurse kemi sqaruar më sipër jemi në pritje të akteve nënligjore.</p> <p>Pyetje 20: Si realizohet regjistrimi, dokumentimi, vlerësimi, ruajtja, monitorimi i qarkullimit, shërbimit në internet të regjistrimit në fushën e pasurive kulturore në pronësi publike dhe private në Republikën e Shqipërisë?</p> <p>Sqarime IKRTK: Bashkëlidhur gjeni VKM nr.278 datë 16.5.2018</p>	
--	--	--	---	--

				<p>“Për krijimin e Bazës së të Dhënave Shtetërore RKPK”.</p> <p>Pyetje 21: A janë krijuar dhe si funksionojnë zyrat rajonale të IKRTK-së dhe zyrat e eksportit të pasurive kulturore të luajtshme? Sqarime IKRTK: Jo, aktualisht nuk janë në funksion.</p> <p>Pyetje 22: Sa raste të monitorimit të procedurave të eksportit për qarkullimin kombëtar e ndërkombëtar, të certifikuar, të pasurive kulturore të luajtshme, janë kryer në bashkëpunim me institucionet ligjzbatuese dhe doganore? Sqarime IKRTK: Sikurse sqaruar më sipër, jemi në pritje të akteve nënligjore lidhur me regjimin e eksport/import të pasurive kulturore.</p> <p>Pyetje 23: Sa tarifa janë mbledhur sipas parashikimeve të përcaktuara nga udhëzimi i përbashkët i ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe ministrit përgjegjës për financat? Sqarime IKRTK: Nuk ka udhëzim të përbashkët ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe ministrit përgjegjës për financat, por aktualisht ofrojmë shërbime pa pagesë në portalin e- albania.</p>		
5	13.04.2024	<p>Kërkesë për informacion mbi transportin e veprave të artit jashtë territorit të Shqipërisë. A. Y</p>	15.04.2024	<p>Në përgjigje të email-it tuaj, ju informojmë se ju mund të kryeni aplikimin për t'u pajisur me vërtetimin e objekteve në portalin e-albania duke kërkuar "<b>Aplikim për regjistrim, si dhe Aplikim për leje zhvendosje të veprave të artit</b>". Në zbatim të ligjit 27/2018 "<i>Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë</i>", pajisja me këtë vërtetim shërben <u>për veprat të cilat do të lëvizin jashtë territorit shqiptar</u> dhe që nuk janë krijuar më shumë se 50 vjet më parë.</p>	E plotë	S'ka

				Për tu pajisur me vërtetimin, Ju duhet të Aplikoni në portalin e-Albania sipas hapave të poshtëcituar: Identifikohuni si individ ose subjekt në portalin e-Albania;Zgjidhni shërbimin "Aplikim për regjistrim, si dhe Aplikim për leje zhvendosje të veprave të artit";Klikoni butonin "Përdor";Plotësoni formularin e aplikimit dhe ngarkoni dokumentacionin përkatës;Më pas kërkesa juaj do të procedohet nga Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore dhe vërtetimin mund ta shkarkoni nga e- Albania.		
6	14.05.2024	Kërkesë për informacion mbi "Aplikim per regjistrim si dhe aplikim per zhvendosje të veprave te artit" S. N	14.05.2024	Në lidhje mbi aplikimin tuaj në <i>e-albania</i> ju informojmë se IKRTK shprehet mbi statusin e e objektit që do të lëvizte jashtë territorit të Shqipërisë. Ky dokument nuk vlen për shitjen e objektit, por vlen vetëm për Drejtorinë e Doganave në rastin e nxjertjes jashtë territorit Shqiptar të veprës/objektit. Lidhur me procedurën e tjetërsimit pronësisë së objektit/veprës drejtohuni pranë një noteri.	E plotë	S'ka
7	20.05.2024	Kërkesë për paisje me pasaportë monumeti të banesës "Llujë", F. H. Ll	21.05.2024	Në përgjigje të kërkesës suaj datë 20.05.2024, "Për pasaportë të monumentit të banesës Ll..", administruar me Nr.213 Prot., datë 20.05.2024 në Institutin Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore (IKRTK), Ju përcjellim informacionin dhe dokumentacionin si vijon: IKRTK në zbatim të Nenit 32 të Ligjit 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", ka kryer procedurat e verifikimit në Bazën e të Dhënave Shtetërore "Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore (RKPK)", për objektin "Banesa e H. Ll, Shkodër", me Nr.Inv 1607 dhe <u>KOD RKPK 33551</u> . Në zbatim të Nenit 50 të Ligjit 27/2018, objekti është pasuri kulturore dhe është subjekt i zbatimit të të gjitha procedurave	E plotë	S'ka

				të parashikuara në këtë ligj. Bashkëlidhur, ju përcjellim pasaportën e gjeneruar nga Baza e të Dhënave Shtetërore "Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore".		
8	14.06.2024	Kërkesë për dhënie informacioni dhe vlera referencë për vepra arti, V. S	18.06.2024	Në përgjigje të email-it tuaj, datë 14.06.2024 " <i>Kërkesë për informacion</i> ", të administruar pranë Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore (IKRTK), lidhur me kërkesën mbi vënien në dispozicion të katalogë çmimesh, referenca të vlerave apo gjendje kontabiliteti të vlerave për objekte të trashëguara, ju informojmë se referuar fushës së përgjegjësisë së IKRTK-së (ligjit 27/2018 " <i>Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë</i> " dhe rregullores së brendshme të institucionit) si dhe pas verifikimeve të kryera në arkiv-protokoll, <u>nuk disponojmë këtë lloj materialesh</u> (katalogë, referenca), për sa kërkuar nga ana juaj.	E plotë	S'ka
9	25.06.2024	Kërkesë mbi aplikimin "Aplikim për regjistrim si dhe aplikim për zhvendosje të veprave të artit", L. B	25.06.2024	Në përgjigje të email-it tuaj datë 25.06.2024 ju informojmë si më poshtë: Ju keni paraqitur kërkesën për " <i>Aplikim për regjistrim, si dhe Aplikim për leje zhvendosje të veprave të artit</i> ", me numër personal aplikimi C.....7 <b><u>në datë 04.05.2024. Në datë 08.05.2024 është kthyer përgjigje mbi këtë aplikimin</u></b> ku konkretisht është dërguar " <i>Vërtetimi</i> ", nga IKRTK. Ju lutem na konfirmoni në qoftë se bëhet fjalë për të njëjtin aplikim ose aplikim tjetër. Sqarojmë se: <b><u>Dokumentin e gjeni në portalin e-albania duke shkuar tek "Hapësira ime" duke klikuar "Dokumentat e mia" dhe më pas "Shkarko".</u></b> <i>Bashkëlidhur gjeni screenshot nga portali e-albania mbi</i>	E plotë	S'ka



				<i>kthimin e përgjigjes si dhe vërtetimin.</i>		
--	--	--	--	--	--	--

---

<sup>1</sup> Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve

<sup>2</sup> Data e regjistrimit të kërkesës

<sup>3</sup> Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

<sup>4</sup> Data e kthimit të përgjigjes

<sup>5</sup> Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

<sup>6</sup> Përgjigja jepet E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/E deleguar

<sup>7</sup> Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.